

EPPC Albania po kërkon një **Specialist të Lartë Blerjesh**, për klientin e saj, që operon në sektorin e retail.

Përgjegjësitë kryesore:

- Gjurmimi dhe vlerësimi i furnitorëve bazuar në çmimin, cilësinë dhe shpejtësinë e dorëzimit;
- Propozon çmimet optimale, kontribuon në diskutimet dhe vendosjen e tyre;
- Analizon dhe ndërton raporte të ecurisë së produktit sipas kategorive dhe propozon zgjidhje për të përmirësuar rezultatet e shitjeve;
- Sigurohet të ketë informacion të vazhdueshëm mbi produktet dhe cmimet e konkurences;
- Përzgjedh dhe përgatit strategjitë e promovimit;
- Është në kontakt të vazhdueshëm me furnitorët përkatës, mban nën kontroll stokun dhe ndjek statusin e porosive;
- Sigurimi i dërgimit në kohë të mallrave dhe shërbimeve;
- Koordinimi me departamente të ndryshme për të kuptuar nevojat e tyre për blerje.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare e preferueshme në **Financë, Administrim Biznesi** ose në fusha të tjera të ngjashme;
- **E preferueshme eksperiencë e mëparshme e maturuar në blerje;**
- **Njohuri të mira të gjuhës Angleze;**
- Aftësi shumë të mira menaxheriale, të punës në grup dhe të negocimit;
- Njohuri në përdorimin e programeve bazë kompjuterike (paketa MS Office).

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.